



MA - 205 MATIBOND



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

6.75-7.5 L / 25kg



KONSUMI

3-5 kg/m²

Përkufizimi i Produktit

MA-205 MATIBOND është një ngjitës me bazë çimento, me rrëshqitshmëri të reduktuar dhe me kohë të zgjatur punimi, që përdoret për ngjitjen e pllakave qeramike.

Veçoritë

- Ka një forcë të lartë ngjitëse.
- Është i përshtatshëm për shtrimin e pllakave nga lartë-poshtë. Nuk lejon rrëshqitjet e pllakave.
- Me kohën e zgjatur të punimit kursen kohë dhe punë.
- I lehtë për t'u krehur me mallë.

Aplikimi

- Sipërfaqja duhet pastruar nga mbetjet që pengojnë ngjitjen. Duhet treguar kujdes që sipërfaqja të jetë e trajtuar dhe të jetë e qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit.
- Pjesët e pasheshuara apo të deformuara mbi sipërfaqen ku do të aplikohet produkti, duhen trajtuar me llaç riparues.
- Sipërfaqja e pluhurosur prapa pllakës duhet fshirë me një leckë të lagur.
- 25 kg MA-205 MATIBOND duhen zbratur me ngadalë në 6.75 – 7.50L ujë të pastër dhe duhen përzier derisa të përfitohet një masë homogjene pa kokrriza. Përziera duhet bërë me mikser me xhiro të ulëta. Nuk duhet shtuar asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin për përdorimin e produktit.
- Llaçi i përgatitur duhet lënë 5-10 minuta për t'u bërë gati për përdorim dhe duhet përzier përsëri 1-2 minuta para përdorimit.
- Konsumi është 3-5 kg/m².
- Llaçin e përgatitur konsumojeni brenda 6 orëve.

- Për të pasur një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje më të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që llaçi mbi nënshtrësë fillimisht të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës dhe pastaj me pjesën e dhëmbëzuar të mallës, e cila duhet zgjedhur në përputhje me llojin dhe përmasat e pllakës.
- Pllakat duhen ngjitur brenda 30 minutave dhe duke ushtruar forcë mbi to, por vendosja e tyre mund të bëhet edhe më shpejt brenda disa minutave, në kushte jo të përshtatshme atmosferike si: temperaturë e lartë, lagështi e ulët apo erë. Në rast të qëndrimit për një kohë të gjatë të llaçit të hapur, mos i ngjisni pllakat, por pastrojini llaçin duke e gërryer nga sipërfaqja ku është aplikuar.
- Mbushjen e fugave bëjeni pasi të kenë kaluar 24 orë nga shtrimi i pllakave në mur dhe 48 orë në dysheme.
- Dyshemeja mund të lejohet për përdorim 24 orë pas mbushjes së fugave.
- Llaçi në enë që i ka kaluar koha e përdorimit apo ka zënë cipë duhet hedhur poshtë. Pas përdorimit, duart dhe veglat e punës duhen larë me ujë të bollshëm, kurse sipërfaqet duhen fshirë me leckë të lagur.
- Pllakat e ngjitura me MA-205 MATIBOND nuk duhet të kenë kontakt direkt me ujin të paktën për 24 orë.
- Temperatura e zbatimit të produktit dhe kushtet e magazinimit duhet të jenë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

Jetëgjatësia në raft

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur.

Magazinimi

Të ruhet në vend të thatë. Thasët të vendosen në stiva e shumta me nga 10 kate.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% RH.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	6.75-7.5 litra ujë / 25 kg
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia e aplikimit	Deri në 10mm
Koha e punueshmërisë	6 Orë
Rrëshqitshmëria (EN 12004-2)	≤0.5mm
Koha e hapjes (EN 12004-2)	Pas 30 minutash ≥ 0.5 N/mm ²
Forca e ngjitjes (EN 12004-2)	
- Fillestare	≥ 0.5 N/mm ²
- Pas ekspozimit ndaj nxehtësisë	≥ 0.5 N/mm ²
- Pas zhytjes në ujë	≥ 0.5 N/mm ²
- Pas cikleve të ngrirjes/shkrirjes	≥ 0.5 N/mm ²
Shkalla e temperaturës	(-40°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS